

VENDIM
Nr. 633, datë 29.7.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN
E NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS FATKEQËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin në fushën e ndërtimit të banesave pas fatkeqësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E
NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS FATKEQËSISË

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, referuar në vijim si “Palët”,

kanë arritur në mirëkuptim sa më poshtë.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi rregullon parimet themelore për realizimin e Projektit në cilësinë e Grantit të Republikës së Turqisë për Republikën e Shqipërisë, për ndërtimin e 522 (pesëqind e njëzetë e dy) banesave pas tërmetit në Njësinë Administrative Laç, Bashkia Kurbini (referuar në vijim si “Projekti”), si një nga zonat e prekura nga tërmeti që ra në Republikën e Shqipërisë, sipas kushteve teknike të pranuar nga Palët dhe në bashkëpunim mes Palëve në përputhje me legjislacionet kombëtare në fuqi në vendet e tyre.

Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, detyrën e autoritetit zbatues për Qeverinë e Republikës së Turqisë do ta kryejë Administrata e Ndërtimit të Banesave Sociale (TOKI) pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Urbanizmit të Republikës së Turqisë, ndërsa për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë do ta kryejë Enti Kombëtar i Banesave.

Neni 2

Korniza ligjore dhe objekti i Projektit

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

2. Në kuadër të Projektit do të realizohen punime ndërtimi për ndërtimin në total të 522 (pesëqind e njëzetë e dy) banesave, si edhe të faciliteteve sociale, me qëllim për të përballuar nevojën urgjente për strehim në zonat e prekura nga tërmeti që ra në Shqipëri më datë 26 nëntor 2019.

Neni 3 Detyrimet e Palëve

1. Autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë do të sigurojnë një truall të përshtatshëm dhe me sipërfaqe të mjaftueshme për ndërtimin e banesave dhe infrastrukturës publike e sociale që do të ndërtohen në kuadër të Projektit në zonat e prekura nga tërmeti.

2. Projektet e ndërtimit dhe të zbatimit për objektin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit do të përmbushen nga TOKI, ndërsa lejet lokale (leja e zhvillimit, leja e ndërtimit, dokumentet për zonimin dhe perimetrin e zonës së zhvillimit, leja për pikën e lidhjes në rrjetin elektrik, leja për lidhjen me rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve në kantierin e përkohshëm të ndërtimit, lejet për makineritë dhe pajisjet e ndërtimit, si dhe kontejnerëve me materiale, ngarkesave të tjera që do të sillen në sheshin e ndërtimit, nëse do të jetë e nevojshme) do të nxirren nga autoritetet përgjegjëse me mbështetjen e njësisë zbatuese, në zbatim kjo edhe të VKM-së nr. 46, datë 22.1.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Laç, Bashkia Kurbin dhe caktimin e Entit Kombëtar të Banesave si njësi zbatuese”. Normat e projektimit dhe të zbatimit për ndërtimet do të jenë sipas standardeve të Republikës së Shqipërisë dhe të Bashkimit Evropian, si dhe të konfirmuara me certifikatën CE.

3. Kontrolli i plotë i projekteve të ndërtimit dhe zbatimit do të ushtrohet nga TOKI. Përpara përfundimit të aktivitetit që është objekt i kësaj Marrëveshjeje, njësi zbatuese për palën shqiptare do të kolaudojë zbatimin e Projektit, në përputhje me dokumentacionin e miratuar dhe standardet e specifikuar në nenin 2 të Marrëveshjes.

4. Dorëzimi i sheshit të ndërtimit do të bëhet sipas tekstit të kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha lejet e nevojshme për TOKI-n, firmën kontraktore dhe firmat konsulente, si dhe nënkontraktorët dhe punonjësit e tyre (si pjesë e delegacionit teknik që do të dërgohet nga Turqia) do të sigurohen nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, me qëllim që t'u mundësohet kryerja e punimeve për ndërtimin e 522 (pesëqind e njëzetë e dy) banesave dhe infrastrukturës përkatëse. Të gjitha përgjegjësitë që kanë të bëjnë me palët e treta që gjenden brenda sheshit të ndërtimit (shpronësimi, boshatisja e godinave në përdorim, shembja e objekteve) dhe të gjitha përgjegjësitë ligjore ndaj personave që detyrohen të dalin nga sheshi i ndërtimi si pasojë e zbatimit të Projektit u takojnë autoriteteve përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë.

5. Parcelat dhe trojet e ndërtimit do të dorëzohen të çliruara nga çdo peng, barrë e pretendim i çfarëdo lloji nga njësi zbatuese e Republikës së Shqipërisë. Problemet që kanë të bëjnë me pronësinë dhe zoonimin, në lidhje me parcelat e ndërtimit (nëse ka) do të zgjidhen nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë dhe do të përshtaten në përputhje me këtë Marrëveshje të rënë dakord mes Palëve.

6. Të gjitha përjashtimet nga detyrimet doganore, të nevojshme për realizimin e Projektit do të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar, nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, si dhe do të jepen të gjitha udhëzimet e nevojshme për Autoritetet Doganore përkatëse.

7. Nëse do të jetë e nevojshme për implementimin e Projektit, autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë do të sigurojnë përjashtimin nga detyrimet doganore për importin e përkohshëm të të gjitha makinerive të ndërtimit, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

8. Kompania turke e ndërtimit që është caktuar nga TOKI për realizimin e Projektit do të jetë e përjashtuar nga taksat dhe/apo tatimet e aplikueshme në Republikën e Shqipërisë, për sa parashikohet në legjislacionin fiskal. Për tatimin mbi të ardhurat (tatimin mbi fitimin dhe tatimin

mbi të ardhurat personale) kompania turke e ndërtimit u nënshtrohet dispozitave të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë për shmangien e tatimit të dyfishtë.

9. Përgjegjësia lidhur me sigurimet shoqërore të punëtorëve dhe të ekipit teknik që do të dërgohet nga Turqia do të rregullohet sipas legjislacionit të Republikës së Turqisë.

10. Lejet bllok të punës (për firmën kryesore kontraktore turke, firmën konsulente dhe për nënkontraktorët e tyre), për të cilat do të ketë nevojë për realizimin e Projektit, do të sigurohen gjatë të gjithë kohës që Projektin do të vazhdojë (përfshirë këtu edhe veprimet që do të sigurohen nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë për lehtësitë dhe lejet e nevojshme, në rast të themelimit në Shqipëri të një dege [branch]/firme, nëse do të ketë nevojë për këtë). Autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, gjithashtu, do të japin lejet e qëndrimit, lejet e punës dhe të gjitha lejet e tjera të nevojshme për personelin e angazhuar gjatë periudhës së mirëmbajtjes, dhe në rast se do të ketë nevojë lejet do të zgjaten me kërkesë të TOKI-it. Gjatë të gjithë kohëzgjatjes së Projektit, të gjitha lejet e sipërcituara do të sigurohen nga Njësia Zbatuese e Republikës së Shqipërisë.

11. Autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë do të garantojnë sigurinë fizike të mallit, pajisjeve dhe jetës së punonjësve të TOKI-t dhe të kontraktorëve të tij.

12. Njësia Zbatuese e Republikës së Shqipërisë do të caktojë/tregojë vendin për mobilizimin e kantierit.

13. Në kuadër të Projektit nuk do të vendoset ndonjë limit dhe kufizim për orarin dhe ditët e punës.

14. E gjithë infrastruktura brenda kufijve të ndërtimit të Projektit do të bëhet nga TOKI dhe kontraktorët e tij, ndërsa ndërtimi i lidhjeve me energji elektrike, furnizimi me ujë, kanalizimet e ujërave të zeza të nevojshme deri në kufijtë e sheshit të Projektit do të sigurohen nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet njësisë zbatuese, në raportin e fuqisë dhe kapacitetin e përcaktuar nga TOKI.

15. Me përfundimin e periudhës ndërtuese të Projektit, pranimi i përkohshëm do të kryhet nga TOKI, kurse lejet e nevojshme për shfrytëzim dhe të gjitha dokumentet e tjera të ngjashme do të sigurohen nga Njësia Zbatuese e Republikës së Shqipërisë dhe për këto nuk do të aplikohet asnjë taksë, tatim apo detyrim.

16. Pasi të jenë siguruar lejet e përmendura në nenet e mësipërme, TOKI dhe firmat kontraktore do t'i dorëzojnë drejtpërsëdrejti Entit Kombëtar të Banesave, si Njësi Zbatuese e Republikës së Shqipërisë, njësitë e banimit, facilitetet sociale dhe infrastrukturën e shërbimeve, pjesët e pavarura, mjediset e përbashkëta, nëse ka të përfunduara. Të gjitha veprimet e tjera në lidhje me dorëzimin e këtyre përfituesve të ligjshëm ose palëve të interesuara u takojnë autoriteteve përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë.

17. Procedurat (veprimet) përfundimtare të pranimin të Projektit do të kryhen nga TOKI pas 24 (njëzet e katër) muajve nga data e pranimin të përkohshëm. Brenda kësaj periudhe TOKI dhe firmat kontraktore do të kryejnë punimet e mbetura mangët ose ndërtimet defektoze, nëse ka, me përjashtim të rasteve ku shkaktar është përdoruesi, si dhe shërbimet e mirëmbajtjes (me kusht që kontratat për mirëmbajtjen e ashensorëve, pompave të ujit dhe pajisjeve të ngjashme të jenë bërë nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë).

Neni 4

Financimi i Projektit

Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, TOKI do të hartojë projektet e ndërtimit dhe të zbatimit për banesat që do të ndërtohen dhe këto projekte do të miratohen nga Palët me konsensus të përbashkët. Kostoja e ndërtimit të banesave dhe vlera e përgjithshme e Projektit do të llogaritet duke marrë për bazë projektet e miratuara.

Neni 5

Krijimi i Grupit të Punës

1. Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të formohet një “grup pune”, ku do të marrin pjesë autoritete përgjegjëse nga Enti Kombëtar i Banesave i Republikës së Shqipërisë dhe TOKI. Grupi i punës do të jetë në kontakt të vazhdueshëm, me qëllim përfundimin e Projektit në kohë dhe zgjidhjen drejtpërsëdrejti të problemeve të mundshme që do të lindin.

2. Në rast se do të shikohet si e nevojshme nga Palët, në lidhje me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi mund të nënshkruhen protokolle shtesë që përmbajnë specifikimet teknike dhe kontratën e ndërtimit.

Neni 6

Vlefshmëria e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi në datën që është marrë njoftimi i fundit, ku Palët informojnë njëra-tjetrën në rrugë diplomatike mbi përfundimin e procedurave të nevojshme që kërkon legjislacioni i tyre i brendshëm për vënien në fuqi të dokumentit në fjalë.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të qëndrojë në fuqi për 1 (një) vit. Në një kohë të çfarëdoshme secila prej Palëve mund të informojë 3 (tre) muaj më parë me shkrim dhe në rrugë diplomatike Palën tjetër lidhur me qëllimin e saj mbi ndërprerjen e marrëveshjes. Marrëveshja do të rinovohet automatikisht me periudha 1-vjeçare (njëvjeçare), për sa kohë që njëra prej Palëve nuk e ka njoftuar me shkrim dhe në rrugë diplomatike Palën tjetër 3 (tre) muaj para se të përfundojë vlefshmëria e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mbi qëllimin e saj për ndërprerjen e tij.

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi nuk do të ndikojë në projektet dhe aktivitetet në vazhdim ose të përfunduara.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së shpjeguar në paragrafin e parë të këtij neni.

Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe protokollat shtesë përkatëse do të jenë në cilësinë e një pjese integrale e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi. Protokollat Shtesë në fjalë, gjithashtu, do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së shpjeguar në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me anë të konsultimeve dhe bisedimeve mes Palëve.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të zbatohet pa dëmtuar detyrimet e Palëve në lidhje me pronësinë intelektuale dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 8

Konfidencialiteti

Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën, në lidhje me realizimin e Projektit do t'i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t'i transferojnë ato tek një palë e tretë pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është nënshkruar më datë 1.7.2020, në Tiranë dhe në Ankara, në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhët shqip, turqisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë të

barasvlershme për nga përmbajtja. Në rast të dallimeve në interpretim, teksti në anglisht do të merret për bazë.

Në emër të

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Arben Ahmetaj

Ministër Shteti për Rindërtim

Në emër të

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Murat Kurum

Ministër i Mjedisit dhe Urbanizimit